

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	23.01.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	26.02.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	PO, 26.02.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019-MFE-07
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Hava Delibashi 0684381875 Hava.delibashi@financa.gov.al Enhela Shehu 0684312017 Enhela.shehu@qkb.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Mospërditësimi në kohë reale nga personat juridikë, i të dhënave të regjistruara në regjistrin tregtar, lidhur me gjendjen e ortakërisë dhe/ose strukturës së ortakërisë së personit juridik, pasjell mungesë të transparencës në subjektet tregtarë.

Në ligjin aktual, nuk ka asnjë masë shtrënguese dhe penalizuese për mosdorëzimin brenda afatit ligjor, nga shoqëria aksionare, të listës së plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj.

Problem tjetër është edhe mungesa e parashikimit në ligj, të së drejtës së administratorit për kryerjen e aplikimit për regjistrim fillestar të personave juridikë.

Në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, parashikohet se aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit apo nga çdo person i autorizuar prej tyre dhe nuk përcaktohet e drejta e administratorit për të kryer këtë veprim.

Ndërhyrja e qeverisë nëpërmjet një politike të caktuar është e nevojshme, pikërisht për forcimin e detyrimit për deklaram, perditësim dhe transparencën e të dhënave në regjistrin tregtar, si dhe për t’i dhënë mundësinë që edhe administratori të parashikohet në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” si një nga personat që kanë të drejtën e aplikimit për të kryer një regjistrim fillestar të personit juridik.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

1. Të përditësohen në kohë në regjistrin tregtar, të dhënat lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.
2. Të rritet më tej transparenca lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.
3. Të parashikohet administratori si një person për kryerjen e regjistrimit fillestar të personit juridik.
4. Të merren masa ndëshkimore administrative ndaj subjekteve, të cilët nuk reflektojnë ndryshimet në regjistrin tregtar brenda afatit kohor.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: – status quo-ja;

Opsioni 1- hartimi i një ligji të ri;

Opsioni 2: – ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar është opsioni nr. 2, sipas të cilit, ndryshimi i ligjit ekzistues do të përcaktojë parshikimin që personat juridikë duhet të regjistrojnë ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, brenda 30 ditëve nga data e ndryshimit faktik të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë në të kundërt, mospërmbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë. Gjithashtu, parashikim tjetër do të jetë edhe dhënia e te drejtës së administratorit për të kryer regjistrimin fillestar të personit juridik.

Këto parashikime që vlerësohen të shtohen në ligjin aktual do të kenë efekte mbi subjektin në rast të mosregjistrimit të ndryshimeve në afatin e vendosur.

Efektet nuk mund të monetarizohen pasi nuk mund të parashikohen rastet e kundërvajtjeve, të cilat do të lindin në të ardhmen.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Është përzgjedhur Opsioni 2: – ndryshimi i ligjit ekzistues, sepse në legjislacionin shqiptar tashmë ekziston ligji për regjistrimin e biznesit, në të cilin përcaktohen procedurat për regjistrimin e biznesit dhe të dhënat që ndryshohen në regjistrin tregtar, përcaktime këto të cilat nuk do të ndryshojnë, por do të ngelen në fuqi.

Për sa më sipër, si dhe në respektim të teknikës legjislative është vlerësuar se ky opsion shërben si masë paraprake dhe më e shpejtë për përmbushjen e rekomandimeve të vendosura nga MONEYVAL dhe arritjes së objektivave të vendosura.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare

menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):		
Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021

KONSULTIMI <i>Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)</i> Projektligji është në fazën e konsultimit publik dhe është hedhur në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.
ZBATIMI DHE MONITORIMI <i>Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?</i> Zbatimi i këtij ligji do të bëhet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila do të verifikojë rast pas rasti respektimin e kërkesës ligjore për rregjistrimin e ndryshimeve brenda afatit dhe do të monitorohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- Jepni kontekstin e politikës

Aktualisht, ligji Nr. 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, parashikon se për regjistrimet e tjera të detyrueshme, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e hartimit të aktit të detyrueshëm për t’u regjistruar. Gjithashtu, ligji aktual parashikon se moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë. Gjithashtu, ligji aktual parashikon se shoqëria aksionare së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, njofton listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj.

Megjithatë, ligji aktual nuk parashikon shprehimisht detyrimin e regjistrimit dhe afatin brenda të cilit personat juridikë duhet të regjistrojnë në regjistrin tregtar ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.

Një nga rekomandimet e MONEYVAL ka qënë rritja e masës së sanksioneve për subjektet të cilat nuk do të bëjnë rregjistrimin brenda afatit të ndryshimeve të ortakut dhe /ose strukturës së ortakërisë.

Për më tepër, në ligjin aktual mosplotësimi i detyrimit që shoqëria aksionare për njoftimin e listës së plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj, nuk përbën kundërvajtje administrative e dënueshme me gjobë.

Gjithashtu, në ligjin ekzistues nuk i jepet e drejta administratorit që të aplikojë për regjistrimin fillestar të personit juridik, e drejtë e cila derivon edhe nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
 - *Identifikoni shkaqet e problemit.*
 - *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
 - *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
 - *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*
- *Problemi 1:* Mospërditësimi në kohë reale nga personat juridikë, i të dhënave të regjistruara në regjistrin tregtar, lidhur me gjendjen e ortakërisë dhe/ose strukturës së ortakërisë së personit juridik.

Shkaqet: Në ligjin Nr. 9723/2007, nuk përcaktohet qartësisht një afat brenda të cilit duhet të regjistrohen ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, si dhe nuk ka asnjë masë shtrënguese dhe penalizuese për mosplotësimin e këtij afati ligjor, por përcaktohet vetëm në mënyrë të përgjithshme dorëzimi i çdo vendimmarrje të detyruar për publikim brenda një afati 30 ditor.

Në ligjin aktual, nuk ka asnjë masë shtrënguese dhe penalizuese për mosdorëzimin brenda afatit ligjor, nga shoqëria aksionare, të listës së plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj.

Nevoja e ndërhyrjes: Ndërhyrja është e nevojshme për forcimin e detyrimit për deklarim, perditësim dhe transparencën e të dhënave në regjistrin tregtar..

Ndryshimet ligjore përsa i përket regjistrimit të ndryshimeve të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, prekin direkt personat juridikë të regjistruar pranë regjistrit tregtar, pasi mospërmblidhja e detyrimit ligjor për përditësimin e të dhënave brenda afatit, do të përbëjë kundërvajtje administrative.

Ndërkohë, këto ndryshime indirekt do të ndikojë pozitivisht tek institucionet të cilët monitorojnë bizneset, veprimtarinë dhe organizimin e tyre si dhe çdo palë të interesuar lidhur me të dhënat e subjekteve të regjistruar pranë regjistrit tregtar.

- *Problemi 2:* Mungesa e parashikimit në ligj, të së drejtës së administratorit për kryerjen e aplikimit për regjistrim fillestar të personave juridikë.

Shkaqet: në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, parashikohet se aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit apo nga çdo person i autorizuar prej tyre dhe nuk përcaktohet e drejta e administratorit për të kryer këtë veprim.

Nevoja e ndërhyrjes: Ndërhyrja për rregullimin e dispozitës ekzistuese, është i nevojshëm për t’i dhënë mundësinë që edhe administratori të parashikohet në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” si një nga personat që kanë të drejtën e aplikimit për të kryer një regjistrim fillestar të personit juridik.

Ky ndryshim ligjor, prek subjektet tregtare të regjistruar pranë regjistrit tregtar, pasi aktualisht administratori nuk parashikohet shprehimisht si person që ka të drejtën për kryerjen e regjistrimit fillestar të një personi juridik.

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Nëpërmjet kësaj politike planifikohet të ndërhyet për të përmirësuar dhe forcuar zbatimin e ligjit për përditësimin në kohë pranë regjistrimit tregtar të të dhënave lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik. Gjithashtu, planifikohet të ndërhyet për të përmirësuar dispozitën ligjore që parashikon personat e autorizuar për kryerjen e regjistrimit fillestar të një personi juridik, duke përfshirë administratorin si një nga personat e autorizuar.

Justifikohet ndërhyrja në ligjin ekzistues pasi aktualisht në ligjin Nr. 9723/2007, nuk përcaktohet qartësisht një afat brenda të cilit duhet të regjistrohen ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, si dhe nuk ka asnjë masë shtrënguese dhe penalizuese për mosplotësimin e këtij afati ligjor, por përcaktohet vetëm në mënyrë të përgjithshme dorëzimi i çdo vendimmarrje të detyruar për publikim brenda një afati 30 ditor. Gjithashtu, në ligjin aktual, nuk ka asnjë masë shtrënguese dhe penalizuese për mosdorëzimin brenda afatit ligjor, nga shoqëria aksionare, të listës së plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj.

Gjithashtu, justifikohet ndërhyrja në ligjin ekzistues pasi aktualisht administratori nuk parashikohet shprehimisht si person që ka të drejtën për kryerjen e regjistrimit fillestar të një personi juridik.

Objekti i politikës

- Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.
- Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë.

Objektivat e këtij projektligji janë:

1. Të përditësohen në kohë pranë regjistrimit tregtar, të dhënat lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.
2. Të rritet më tej transparenca lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.
3. Të parashikohet administratori si një person i autorizuar për kryerjen e regjistrimit fillestar të personit juridik.
4. Të merren masa ndëshkimore administrative ndaj subjekteve, të cilët nuk reflektojnë ndryshimet në regjistrin tregtar brenda afatit kohor.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Opsioni 0: – status quo-ja - nuk pësojnë ndryshim kërkesat aktuale.

Në kushtet e zbatimit të ligjit aktual, ku pavarësisht parashikimit të detyrimit për regjistrimin e të dhënave lidhur me ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, mungesa e një afati ligjor brenda së cilës këto të dhëna duhet të regjistrohen nga data e ndryshimit faktit të saj, si dhe mungesa e parashikimit të një sanksioni të shprehur administrativ bën që të mos garantohej në kohë zbatimi i këtij detyrimi ligjor.

Me situatën aktuale nëse nuk ndërhyjmë me rregullime ligjore, atëherë nuk garantohej zbatimi i detyrimit ligjor për regjistrimin në kohë, të të dhënave lidhur me ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik. Gjithashtu, nëse nuk ndërhyjmë në ndryshime ligjore, atëherë administratori përsëri nuk do të parashikohet si një nga personat për kryerjen e regjistrimit fillestar të një personi juridik.

Opsioni 1- hartimi i një ligji të ri, në të cilën të rregullohet dhe sanksionet detyrimi i regjistrimit brenda një afati ligjor të të dhënave lidhur me ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik. Ky opsion nuk do të zgjidhte situatën aktuale, pasi procedura për regjistrimin e të dhënave pranë regjistrarit tregtar, pjesë e së cilave janë dhe të dhënat lidhur me ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, si dhe personat përgjegjës për kryerjen e regjistrimit fillestar të një personi juridik është e parashikuar të rregullohen në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.

Opsioni 2: – ndryshimi i ligjit ekzistues – Ky konsiderohet si opsioni i vetëm që arrin objektivat e politikës, pasi me ndryshimet ligjore garantohej forcimi i përmbushjes së detyrimit të subjekteve tregtare, për të regjistruar në kohë të dhënat lidhur me ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik. Konkretisht, me ndryshimet ligjore, ky detyrim parashikohet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e ndryshimit faktik të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë në të kundërt, mospërmbushja e tij përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë. Gjithashtu, saktësohet dispozita ligjore në të cilën parashikohen personat e autorizuar për kryerjen e regjistrimit fillestar të personit juridik duke përfshirë dhe administratorin mes tyre.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasojë të papritura.*

- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- o *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Ndikimet joekonomike

Grupet e prekura:

- **Subjektet e regjistruara pranë regjistrit tregtar**

Ndikim direkt- saktësimi i dispozitës ligjore në të cilën parashikohen personat e autorizuar për kryerjen e regjistrimit fillestar të personit juridik duke përfshirë dhe administratorin mes tyre.

Ndikim direkt- mosregjistrimi brenda afatit 30 ditë nga ndryshimi faktit i të dhënave lidhur me ndryshimin e ortakërisë dhe/ ose strukturës së ortakërisë përbën kundërvajtje administrative.

Ndikim indirekt- mosshlyerja e sanksionit administrativ, të vendosur si pasojë e mosregjistrimit brenda afatit 30 ditë nga ndryshimi faktit i të dhënave lidhur me ndryshimin e ortakërisë dhe ose strukturës së ortakërisë, përbën shkak për pezullimin dhe refuzimin e aplikimit për regjistrimin të një të dhëne përkatëse pranë regjistrit tregtar.

- **Palët e interesuara**, të cilat monitorojnë të dhënat e regjistruara pranë regjistrit tregtar, pjesë e së cilave janë dhe të dhënat lidhur me ortakërinë dhe strukturën e ortakërisë.

Ndikim indirekt: Ky opsion do të sjellë rritjen më tej të transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.

Ndikime ekonomike

Nëpërmjet ndryshimeve të kërkuara ligjore synohet përmirësimi i dispozitave ligjore ekzistuese, të cilat nuk sjellin kosto ekonomike dhe financiare mbi buxhetin e shtetit.

Për shkak se monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore të ndryshuara do të kryhet rast pas rasti nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në këtë fazë është e vështirë të parashikohen ndikimet ekonomike dhe si rrjedhojë nuk mund të monetarizohen.

Për këtë arsye, për shkak se opsionet nuk mund të kuantifikohen lehtë, është aplikuar analiza me shumë kriteret, referuar si më poshtë (kriteret):

1. Rritja e mëtejshme e transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik;
2. Parashikimi shprehimisht i afatit brenda të cilit personat juridikë duhet të regjistrojnë në regjistrin tregtar ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, si dhe vlerës së gjobës në rast të mosplotësimit të detyrimi ligjor;
3. Klasifikimi si kundërvajtje administrative e dënueshme me gjobë, i mosplotësimit nga shoqëria aksionare të detyrimit ligjor që së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe

raportin e auditimit, të njoftojë listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj;

4. Kryerja e përmirësimeve në dispozitat ligjore përsa i përket personave që lejohen të bëjnë aplikimin për regjistrimin fillestar të personave juridikë;

Ndërkohë, për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-4; Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës së opsioneve

Kriteret	Pesha	Opsioni 1	Opsioni 2
Rritja e mëtejshme të transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik	3	0 (0)	5 (15)
Parashikimi shprehimisht i afatit brenda të cilit personat juridikë duhet të regjistrojnë në regjistrin tregtar ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, si dhe vlerës së gjobës në rast të mosplotësimit të detyrimi ligjor.	4	5 (20)	5 (20)
Klasifikimi si kundërvajtje administrative e dënueshme me gjobë, i mosplotësimit nga shoqëria aksionare të detyrimit ligjor që së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, të njoftojë listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj	4	5 (20)	5 (20)
Kryerja e përmirësimeve në dispozitat ligjore përsa i përket personave që lejohen të bëjnë aplikimin për regjistrimin fillestar të personave juridikë.	1	1 (1)	5 (5)
Pikët		41	80

Në bazë të analizës së matricës së performancës së dy opsioneve rezulton se opsioni 2 (ndryshimi i ligjit ekzistues) ka më shumë pikë prandaj ai është opsioni i preferuar.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar është zgjedhur opsioni 2 - ndryshimi i ligjit ekzistues.

Opsioni 2, konsiderohet si opsioni i vetëm që arrin objektivat, pasi nëpërmjet ndryshimeve ligjore garantohet rritja e mëtejshme e transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.

Konkretisht, me anë të përcaktimit të një afati ligjor dhe sanksionimit administrativ, gjobë garantohet forcimi i detyrimit ligjor për përditësimin e të dhënave lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik. Gjithashtu me anë të këtij projektligji, plotësohen objektivat dhe arsyet për ndërhyrjen në ligj: përditësohen në kohë pranë regjistrimit tregtar, të dhënat lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik; rritet më tej transparenca lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik si dhe saktësohet dispozita ligjore në të cilën parashikohen personat e autorizuar për kryerjen e regjistrimit fillestar të personit juridik duke përfshirë dhe administratorin mes tyre.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përkrahuesit masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Monitorimi dhe vlerësimi i opsionit që do të zbatohet do të kryhet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, rast pas rasti bazuar në aplikimet e kryera nga subjektet pranë regjistrimit tregtar. Në rast se, nga verifikimi i kryer, rezulton se subjektet nuk kanë regjistruar brenda afatit 30 ditor ndryshimet lidhur me ortakun dhe/ose strukturën e ortakërisë të personit juridik atëherë ndaj tyre do të aplikohet sanksioni administrativ gjobë. Gjithashtu, referuar procedurës së regjistrimit, të parashikuar në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, mosshlyerja e këtij sanksioni administrativ, përbën shkak për refuzimin e regjistrimit të aplikimeve vijuese.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Pas hyrjes në fuqi, të ndryshimeve ligjore përkatëse, monitorimi i zbatimit të tyre do të kryhet nga Qendra Kombëtare e Biznesit rast pas rasti, referuar aplikimeve për kryerjen e regjistrimit të të dhënave pranë regjistrimit tregtar.

Konstatimi rast pas rasti, i mospërmblendjes së detyrimit përkatës do të përbëjë sanksion administrativ, mosshlyerja e së cilës referuar nenit 54, të Ligjit (e cila është dispozita në bazë të së cilës shqyrtohen aplikimet), nuk lejon kryerjen e miratimit të aplikimeve vijuese pranë regjistrimit tregtar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Shënim: Në paragrafin më sipër, “Analiza e ndikimeve”, kemi cituar që implementimi i opsionit 2 (i preferuar) nuk ka kosto shtesë ekonomike dhe financiare si dhe ndikimet e këtij opsioni janë të një natyre të tillë, të cilat në këtë fazë nuk mund t’i monetarizojmë.

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

